



Prishtinë, 15 tetor 2018
Kodi i ZRRE-së: V_1048_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenin 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Nenin 47 dhe Nenin 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Rregullën për vendosjen e të hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU);
- Dispozitat e rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe të Tregut (Rregulla për Të Hyrat e OST/OT);
- Dispozitat e rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Të Hyrat e OSH);
- Vendimin e KOSTT-it nr. V_1028_2018 për të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Tregut SH.A (KOSTT);
- Vendimin e OSSH-së nr. V_1027_2018 për të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga Operatori i licencuar i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH); dhe
- Aplikacionin/Kërkesën e KESCO/Furnizuesit me Shërbim Universal për përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara ,të dorëzuar më datën 19 janar 2018, në kuadër të Shqyrtimit Tarifave të Energjisë Elektrike me dokumentacionin relevant sqarues,

në seancën e mbajtur më 15 tetor 2018 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHEN TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA (MAR)** për Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU/KESCO), për vitin relevant tarifor 1 prill 2018-31 mars 2019 që do të mblidhen nga KESCO/FSHU, përmes tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar.
- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale të Furnizuesit me Shërbim Universal** që mbulohen nga tarifat me pakicë të energjisë elektrike për vitin relevant tarifor, pas përshtatjeve vjetore të rregullta të të Hyrave Maksimale të Lejuara do të jenë **214,317,912 euro**.



- III. Furnizuesi i Shërbimit Universal sipas këtij Vendimi udhëzohet t'i përgatis dhe dorëzoj në ZRRE propozimin për aprovim të tarifës së rregulluar me pakicë para vitit relevant tarifor.
- IV. Tarifat e propozuara nga i licencuari duhet ndjekur parimet e vendosura në Rregullën për vendosjen e të hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU).

ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datën 19 janar 2018, nga KESCO- Furnizuesi i Shërbimit Universal, ka pranuar kërkesën për të Hyrat e Lejuara Maksimale, që Furnizuesi i Shërbimeve Universale lejohet të mbledhë nga tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar.
- ZRRE me rastin e vendosjes për të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga FSHU ka marrë parasysh dokumentet që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së:
- Raport Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale Shqyrtimi Periodik për OST/OT, i publikuar me datën 24 gusht 2018;
 - Raport Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale Shqyrtimi Periodik për OSSH, i publikuar me datën 24 gusht 2018;
 - Raport Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale- Furnizuesi me Shërbim Universal, i publikuar më datën 13 shtator 2018;
 - Raport Përfundimtar për të Hyrat e Lejuara Maksimale OST/OT – Përgjigjet ndaj Komenteve, i publikuar me datën 24 shtator 2018;
 - Raport Përfundimtar për të Hyrat e Lejuara Maksimale OSSH– Përgjigjet ndaj Komenteve, i publikuar me datën 24 shtator 2018;
 - Raport Përfundimtar për të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU-në – Përgjigjet ndaj Komenteve, i publikuar me datën 15 tetor 2018;
 - Bordi i ZRRE pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të zbatohet nga Furnizuesi i Shërbimit Universal nga 01 tetor 2018 deri në shqyrtimin e rregullt tarifor, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Furnizuesit me Shërbim Universal (KESCO), dhe
- Arkivit të ZRRE-së